

Kontaktet

Adresa : Rr."Eordej", Km 1, Korçë, Shqipëri.

Telefon : 082 251135

Email : info@fixpro.al

Web : www.fixpro.al

FIX

Shija e familjes

www.fixpro.al

PËRMBAJTJA

02 | Historia Jonë

04 | Fabrika

06 | Produkte për familjen

10 | Produkte për Horeca

15 | FIX Group

HISTORIA JONË

"FIX PRO" sh.p.k nisi të ushtroj aktivitetin në fushën e sallamerisë që prej vitit 2003. Ndërsa themeluesi i saj që nga viti 1992 kishte filluar aktivitet si distributor ekskluziv i markave ndërkombëtare të erëzave, aromave dhe aditivëve për sallameritë e ndryshme.

Sipërmarrja me erëzat,aromat dhe aditivët e ndryshëm bëri të mundur që themeluesi z.Nesti Tarusha të krijonte dhe shpërndante anembanë Shqipërisë receta të shumëllojshme sallamrash në sallameri të ndryshme të mirënjohura të kohës.





Eksperienca e akumuluar në vitet e para të demokracisë me lëndët e para si dhe me artin e krijimit të recetave solli si rrjedhojë momentin e ndërmarrjes së një iniciative të guximshme për z.Tarusha në vitin 2003 duke themeluar sallamerinë "FIX" në qytetin e tij të lindjes, Korçë. Tregu i sallamerive në atë kohë kishte 3-4 sallameri të tjera të cilat kishin konsoliduar pozitat në këtë sektor. Megjithatë për z.Tarusha ky fakt nuk përbënte pengesë për të iniciuar biznesin e tij, pasi baza dhe elementët kryesor si njohja dhe aktiviteti më lëndën e parë, arti i krijimit të recetave si dhe guximi për të penetruar në treg ishin pikat më të forta.

Llojshmëria e produkteve me të cilat "FIX" hyri në treg dhe evoluimi i shpejt brenda pak viteve dhe në shpërndarjen gjeografike të produkteve shoqëruar me recetat unike në shije dhe aroma të sallameve, bënë të mundur që brenda një kohe relativisht të shkurtër sallameri "FIX" të renditej në 5 kompanitë kryesore në këtë industri. Inovacioni ishte hapi i radhës për tu konsoliduar drejt standardeve europiane përmes aplikimit të teknologjive më të fundit gjermane në këtë sektor si dhe imazhi i ri i kompanisë i zbatuar në të gjithë linjën e produkteve.





FABRIKA

Investimi madhor i sallameri "FIX" jo vetëm në industrinë e sallamerisë por edhe në industrinë shqiptare në tërësi përbën një nga asetet kryesore të kësaj kompanie.

Me një sipërfaqje totale prej 4,500 m² janë plotësuar standardet europiane për garantimin e kushteve të punës për një produkt sa më cilësor dhe me një cikël prodhimi të specializuar.

Ky investim shërben si garanci jo vetëm për përmbushjen e standardeve europiane të cilësisë, kontrollit ushqimor por edhe monitorimit të produktit, duke bërë të mundur që prodhimi "made in Albania" i "FIX" të ketë qasje tek konsumatori europian dhe jo vetëm.

Teknologjia e kompanisë së mirënjohur gjermane "CSB" për sistemet e cilësisë dhe menaxhimit të kontrollit në procesin e prodhimit ka sjellë mbylljen e ciklit të gjurmueshmërisë së produktit deri tek konsumatori fundor.





PRODUKTE PËR FAMILJEN

Kompania "FIX" ka një gamë të gjerë produktesh për konsumatorin familjar ku përfshihen kategori të ndryshme si sallame të llojeve të ndryshme, sallame krudo, parizer, salçije & kremviçe pule, proshuta, produkte të zgarës, si dhe produktet ekskluzive si salçiq dhie apo të patentuara si sallam "Si Qëmoti".



Proshutë Gjell deti

90% fileto gjell deti, niseshte e modifikuar, kripë, erëza të zgjedhura.



Pançetë e tymosur

Pançetë derri e zgjedhur.
I tymosur në mënyrë tradicionale me dru ahu.



Kabanos special i thatë

Mish I zgjedhur vici , derri.
I tymosur , i stazhionuar në mënyrë natyrale.



Proshutë e tymosur

Mish kofshe derri.
Kalon në proces pjekje dhe tymosje.



Si Qëmoti

Prodhuar sipas mënyrës tradicionale të krahinës nga mish i zgjedhur derri, viçi.
I trajtuar nga një proces i veçantë termik.



Hungarez crudo

Prodhuar nga mish i zgjedhur derri, viçi.
Recetë tradicionale Hungareze.



Chorizo crudo

Prodhuar nga mish i zgjedhur derri, viçi.
I stazhionuar në ambiente me lagështi.



Salçiçe dhie

Prodhuar 100% nga mishi i dhisë i zones së Korçës.
Erëza të zgjedhura.



Salçice Speciale

Mish i ndarë mekanikisht dhe erëza të zgjedhura.
I zier, i tymosur.



Sallam Napolitan

Prodhuar nga mish i zgjedhur derri, viçi.
I zier, i tymosur.



Parizer

Prodhuar nga mish i zgjedhur derri, viçi.
I zier.



Pariza Tost

Prodhuar nga mish i zgjedhur derri, viçi.
I zier.



Kremvice e tymosur

Mish derri, viçi.
Tymosur në mënyrë tradicionale nga druri i ahut.



Kolloface

Mish i zgjedhur viçi, derri.
Shije karakteristike e krahinës.



Kremviçe pule

Mish pule i ndarë mekanikisht
I zier, i tymosur.



Salçiçe pule

Mish pule i ndarë mekanikisht.
I zier, i tymosur.



Sallam Luiziana

Prodhuar nga mish derri, pule dhe
erëza te zgjedhura. I zier.



Sallam Popullor Pikant

Mish pule i ndarë mekanikisht, mish derri, erëza,
spec djegës. I zier, i tymosur.



Sallam Popullor

Mish pule i ndarë mekanikisht, mish derri, erëza.
I zier, i tymosur.



PRODUKTE HORECA

Sektori i "HORECA" mbulohet nga një larmishmëri produktesh të kompozuar enkas për nevojat dhe specifikat e restoranteve, hotelerive, furrave të bukës si dhe zgarave. Cilësia, shërbimi dhe dedikimi i përqendruar i kompanisë "FIX", e bën atë një partner të bizneseve që operojnë në industrinë e turizmit dhe shërbimeve.



Sallam Koktejl Horeka

Mish derri, viçi dhe erëza të zgjedhura.
Tymosur në mënyrë tradicionale nga druri i ahut.



Kremvçe Horeka

Mish derri, pule.
Erëza të zgjedhura.



Hot Dog

Mish pule i ndarë mekanikisht.
Erëza të zgjedhura.



Sallam Frankfurter

Prodhuar nga pjesë të zgjedhura
të mishit të derrit. I zier, i tymosur.



Sallam Peperoni

Produkt pikant, me përbërje mish viçi dhe derri.
Kalon në proces pjekje dhe tymosje.



Suxhuk Kosove

65% mish viçi dhe 35% mish pule.
Produkt pikant, kalon në proces pjekje dhe tymosje.



Llukanik me rigon

Në përbërje ka mish derri.
I marinuar dhe trajtuar me erëzat tradicionale të Korçës me përqendrim kryesor, rignonin.



Salçiçe dhie

Prodhuar 100% nga mishi i dhisë i zones së Korçës.
Erëza të zgjedhura.



Salçiçe Romano

Receta bazë është tipike e jugut të Italisë.
Produkt i freskët, pjesë të zgjedhura nga mishi i derrit.



Sallam Bratwurst

Produkt tipik bavarez, 100% mish derri.
Erëza karakteristike të zonës së Bavarisë.



Salçiçe Grill

Produkt i freskët, 100% mish derri.
Mund të piqet ose skuqet.



Llukanik fshati

Në përbërje ka mish viçi dhe derri.
I marinuar me verë të kuqe dhe i trajtuar me aroma tradicionale të Korçës.



Salçice speciale me gouda

Në përbërje ka mish viçi, derri dhe djathë Gouda.
Trajtuar me një gamë erëzash.



Shishqebap pule

Pjesë nga gjoksi i pulës.
Erëza të zgjedhura.



Qofte

Produkt i ngrirë.
Mund të piqet ose skuqet.



Shishqebap pule me pançetë

Pjesë nga gjoksi i pulës,
pançetë derri.



Shishqebap derri

Mish derri.
Erëza të zgjedhura.



Chicken Wings

Mish i zgjedhur pule.
Marinuar me aroma specifike pikante.



Burger pikant

Mish viçi, pule dhe derri.
Specifikë erëzash të kombinuara.



Parma crudo (Italian)

Kofshë derri 100%.
Trajtuar me një gamë erëzash capsicum dhe
e stazhionuar për 80-90 ditë.



Parma crudo (Parmanello)

Kofshë derri 100%.
Trajtuar me specifikë të veçantë aromatike
dhe e stazhionuar për 80-90 ditë.



Proshutë pule

Pjesë nga gjoksi i pulës.
Kalon në proces zierje.



Mish i tymosur

Kofshë derri.
Kalon në proces pjekje dhe tymosje.



Sallam Milanez

25% mish viçi dhe 75% mish derri.
Produkt gjysëm i thatë me
specifik intensiteti aromatik.



Bresaola

100% mish viçi. Pjesë nga fileto e viçit.
Marinim specifik me verë dhe e
stazhionuar për 80-90 ditë.

FIX GROUP

FIX/ SI QËMOTI/ DELIKATESË/ TRESOR ART BOUTIQUE





FIX DELIKATESË

Emri "FIX Delikatese" vjen së pari si asociim i përkujdesjes në shërbimin ndaj klientit duke ofruar kushtet më të mira për të konsumuar produkte të freskëta dhe cilësore. Dyqanet "FIX Delikatese" nuk do të jenë thjesht pikaq ushqimore ku do tregtohen produkte, por ato do të shërbejnë si "oaze" ku konsumatori do të ndjehet fillimisht i sigurt, komod dhe i vlerësuar nga stafi i dyqanit i cili do të kryej dhe procesin e këshillimit mbi produktet që do të ofrohen.

Pas një përvoje prej dy dekadash në industrinë e mishit të përpunuar, ekskluzivitetit të recetave unike, investimeve të fundit teknologjike në fabrikën e re vjen si rrjedhojë dhe nevojë e kërkesave nga tregu investimi në rrjetin e dyqaneve "FIX Delikatese" me tipologji marketi ku në fokus do të jenë produkte si mishi, sallameria, bulmeti, sektori i verërave, buka etj.

Ndërthurjes së imazhit të ri të kompanisë "FIX" në treg i është bashkëngjitur koncepti inovativ arkitekturor i ilustruar në mobilimin dhe dizajnin e brendshëm të dyqaneve "FIX" për ti ardhur përshtat kërkesave në rritje të klientelës jo vetëm për produktet por edhe për kushtet ku ato tregtohen, duke krijuar kështu një ekspozitë dhe jo thjesht një dyqan.





FIX SI QËMOTI

Tradita e sallamerisë "FIX" e kombinuar me pasionin për ti ofruar një xhevahir Pazarit të Vjetër të Korçës në industrinë e shërbimit ushqimor dhe argëtimit, solli restorantin dhe zgarën më unike në këtë qytet dhe jo vetëm, "Fix Si Qëmoti".

Tashmë pjesë e "FIX Group", restoranti dhe zgara "Fix Si Qëmoti" synon të shtrij shijen dhe unikalitetin e saj dhe në qytete të tjera të Shqipërisë duke shpërndarë kështu më së miri traditën korçare të kulinarisë si dhe recetat unike të saj.



TRESOR ART BOUTIQUE

Hoteli "Tresor Art Boutique" pjesë e "FIX Group", operon në qytetin e Korçës nga prej 15 Gushtit të vitit 2020. E vendosur në qendër të qytetit, Tresor Art Boutique sjell ndërthurjen e antikes me modernen, unikes dhe artit të bukur.

Vila e ndërtuar ne vitin 1933, është një ndër më të rrallat e llojit të saj jo vetëm në qytetin e Korçës por në të gjithë Shqipërinë. Ajo na çon pas në kohë, në kohën e arkitekturave magjepsëse të aristokracisë shqiptare. Veçantia ndodhet në pikturat murale të vitit 1936 nga familja Zografi të cilat janë restauruar me shumë kujdes. I vendosur në qendër të qytetit, ofron dhoma në standart të lartë, shërbimin e barit dhe restorantit.